

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: Hidroterm SH.P.K., Brigada 123, 23000, Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	15.08.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim**, të parashtruar me datë: **14.08.2023**, nga Operatori Ekonomik: **Hidroterm SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC** me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuare Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Hidroterm SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC** me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me me hapat e më tutjeshëm për këtë aktivitetin të prokurimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **Hidroterm SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, me datë: **14.08.2023**. si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI I QENDRËS RINORE DHE KULTURORE NË RAHOVEC** me Numër të prokurimit: **623-23-2255-5-1-1**, Numër i brendshëm: **623-23-031-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-ës të publikuar me: **09.08.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 citoj:

Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar

Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, ***mbështetje nga Banka*** ose akses në kredi nga banka në vlerë prej së paku 200,000.00 €

Dëshmia 2 Dokumenti të jetë origjinal I nënshkruar dhe vulosur nga institucioni banker

lidhur me këtë projekt Duke u bazuar në kërkesen e FTD dhe dokumentin që ne e kemi paraqitur për të ju përgjigjur kërkeses tuaj ne FTD, besojmë që ju keni shkelur nenin 7 të LPP ,

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi.

Letër Mbështetja nga banka që ne e kemi paraqitur i plotëson kriteret e përcaktuar ne FTD sepse i përgjigjet ne plotshmëri kërkeses.

Kërkesa e paraqitur nga ana juaj nuk është kërkesë e pakushtëzuar nga banka, por është e përcaktur qartë, mbështetje nga banka ose akses në kredi.

Ne e kemi paraqitur Letër Mbështetjen nga banka për këtë projekt në përputhshmëri me kërkesat në FTD, për të cilën komisioni vlerësues është dashur të e pranojë.

Një rast të ngjashëm e kemi edhe në një procedurë tjetër ku AK Komuna e Rahovecit e ka pranuar një Letërmbështetje nga Banka me përmbajtje të njëjtë dhe OE e ka shpallur si të përgjegjshëm, madje ju keni referuar edhe vendimeve të OSHP që e mbështesin një doc të tillë. Shih foton më poshtë...

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë: "FAMIS CO - HC" SH.A, lidhur me kriterin në fjalë të FDT-se, ka të bashkangjitur Letër Referencë nga ProCredit Bankë (citim): *Nëse klienti "FAMIS CO - HC" SH.A, kërkon mbështetje financiare në emër të tenderit: NDËRTIMI I SHESHIT QENDROR TË QYTETIT – RITENDERIM, me Numër të prokurimit: 623-22-6778-5-I-1 nga Komuna e Rahovecit, Pro Credit Bank do të konsiderojë mbështetjen financiare në shumën prej: 150,000.00 Euro, duke u bazuar në kapacitetin e tij financiare pas analizës financiare të bërë nga Këshilltaret e Klientëve për Biznes. Dokumenti është lëshuar me datë: 07.09.2022, ndërsa Analiza financiare është qështje e brendshme e Bankës.*

Duke marr parasysh kriterin e kërkuar në Dosjen e tenderit, që kërkon garancionin bankar për realizimin e kontratës, Operatori Ekonomik ka dëshmuar me Letër Referencë....nëse i plotëson konditat e bankës dhe nëse është i suksesshëm për projektin në fjalë do të mbështesim.

Si dhe Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk gjendet në listën e zeze të FATF (Financiar Action ose Task Force).

Për këtë çështje ka Vendim edhe nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, PSH. Nr. 991/20; 1019/20; 1020/20; dhe 1035/20 i dt. 11.01.2021, dhe Vendimi nga Paneli Shqyrtues PSH.nr. 86, 101, 109, 114/21, dt. 12.03.2021

Andaj pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara.

Përgjigjja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.1

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.1 **nuk qëndron**. Autoriteti Kontraktues gjegjësisht Komisioni vlerësues ka vepruar konform dispozitave ligjore përkatësisht nenit 59.4 të LPP-ës. Letër mbështetje e lëshuar nga banka për ju si Operator ekonomik nuk ofron as minimumin e sigurisë për Autoritetin Kontraktues që ju si Operator Ekonomik do të keni mbështetje në mjete e kërkuara, e njëjta vërteton se ju jeni klient i kësaj banke dhe banka potencon se **mund** ta mbështesin nëse ju si klient plotësoni kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës. **Më shumë pasiguri të komisioni vlerësues** sjell fjalë të fundit në dokumentin në fjalë, ku është e potencuar nga Institucioni bankar **që banka nuk ka dhe nuk pranon asnjë përgjegjësi financiar ndaj përfituesit ose AK-ës në bazë të këtij dokument.**

Për më tepër rasti i lartë përmendur nga ana juaj (Letër mbështetje e ofruar nga Operatori Ekonomik) për Aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i Sheshit Qendror të qytetit – Ritenderim nuk mund të krahasohet me rastin konkret ngase OSHP ka kërkuar vete sqarim nga banka për mbështetje financiare dhe banka e ka konfirmuar një gjë të tillë.

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.2 citoj:

Kapaciteti Teknik dhe Profesional

Kërkesa 2: 2.7. Master në Menaxhimin e Emergjencave - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në lemin nga fusha e siguriës dhe shëndetit në punë).

Dëshmia 2: Certifikatat për stafin profesional duhet të jenë të noterizuara, për pikën 2.7 Duke ju referuar kërkesës në FTD, ne e kemi prezantuar Inxhinierin Master i Menaxhimit të Emergjencave i cili gjithashtu është i certifikuar në lemin e Sigurisë dhe shëndetit në punë nga “Bliterm” dhe i plotëson kushtet e paraqitura në FTD sipas kërkesës.

Në kërkesen tuaj ne FTD nuk e përcakton që Inxhinieri I Emergjencave duhet të jetë i certifikuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqejës Sociale, prandaj ne e kemi paraqitur Certifikaten e cila është lëshuar nga “Bliterm” kompani e cila është e licensuar për të ofruar këto shërbime..

Duke mos e specifikuar qartë në FTD që Inxhinieri i Menaxhimit të emergjencave duhet të jetë i certifikuar nga MPMS apo me një formë specifike të certifikimit atyher komisioni vlerësohet ka shkelur Nenin 19 pika 19.4 të RRPP-001/2022, ku thot:

19.4 Përshkrimi i specifikimeve teknike/Termat e referencës do të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqet kufizime të pa arsyeshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Specifikimet duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë paqartësi rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara.

Ju rikujtojmë që Certifikata për z. Ahmet Morina është e lëshuar nga kompania BLITERM (person juridik) e licensuar nga Qeveria e Kosovës përkatësisht MPMS për trajnimin e punonjësve në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe certifikimin e tyre pas ndjekjes së trajnimit. Foto më poshtë, licensa.

- Përgjigja e AK ndaj Pretendimit Ankimor me Nr.2

Pretendimi ankimor i parashtruar nga OE me Nr.2 gjithashtu **nuk qëndron** ngase AK nuk e ka kontestuar licencimin e kompanisë BLITERM si person juridik licensuar nga Qeveria e Kosovës përkatësisht MPMS për trajnimin e punonjësve në aspektin e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe certifikimin e tyre por që kërkesa e AK-ës ka qenë:

“Kërkesa 2: 2.7. Master në Menaxhimin e Emergjencave - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, (i njëjti duhet të jetë i certifikuar në lëmin nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë)”. Ndërsa ju si Operator Ekonomik si dëshmi keni ofruar një Certifikatë për personin në fjalë me të cilën vërtetohet **se i njëjti ka ndjekur trajnimin nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë** por që nuk keni ofruar certifikatë që vërteton **certifikimin** e të njëjtit në lëmin e kërkuar. Pra komisioni i vlerësimit edhe në këtë rast ka vepruar në bazë të nenit 59.4 i cili përcakton:

“Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.....”

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:

Zyra e Prokurimit

Komuna e Rahovecit